

Raport

nga

Vizita studimore në Stamboll

21-25 Dhjetor 2011



Instituti për Planifikim Hapësinor



Vendi:	Stamboll - Turqi
Data:	21 - 25 Dhjetor 2011
Organizmi:	Organizimi dhe financimi është realizuar në bashkëpunim me CHwB-në përkatësisht Projektin "Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor qendror dhe lokal"
Pjesëmarrës:	Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH) Luani, Elvida, Arbni, Festa, Fatoni, Gëzimja, Shpendi, Nexhmija, Besimi dhe Zana Trashëgimia Kulturore pa Kufi (CHwB) Enesi, Miri, Senati dhe Menori

Nga data 21.12.2011 deri më 25.12.2011, në bashkëpunim me organizatën Trashëgimia Kulturore pa Kufi (CHwB) kemi organizuar vizitën studimore në qytetin e Stambollit (Turqi). Qëllimi i shkuarjes atje ka qenë njoftimi me trashëgiminë kulturore dhe arkitekturën moderne të Stambollit.



Pjesëmarrësit

Disa të dhëna për Stambollin – Stambolli është qyteti më i madh i Turqisë si për nga sipërfaqja ashtu edhe për nga numri i banorëve. Sipërfaqja e provincës (komunës) metropolitane të Stambollit është 5343 km². Rezultati i regjistrimit të popullsisë në vitin 2010 që është bazuar në adresa ka treguar se në këtë komunë metropolitane jetojnë 13.26 milion banorë (në bazë të informatave jozyrtare ky numër duhet të jetë shumë më i madh). Ky numër përbën 18% të numrit të popullsisë së Turqisë që është 74 milion. Stambolli është qendër kulturore, ekonomike dhe financiare e Turqisë. Ai është metropoli i vetëm në botë që shtrihet në dy kontinente. Kanali i Bosforit e ndanë pjesën aziatike të Stambollit nga pjesa evropiane. Stambolli konsiderohet si qytet botëror dhe shumë i vjetër i cili gjatë historisë së tij të gjatë ka qenë kryeqendra e katër perandorive (Perandorisë Romake, Perandorisë Bizantine, Perandorisë Latine dhe Perandorisë Otomane). Është e kuptueshme se këto perandori në kryeqendrën e tyre do të lënë gjurmë më të thella kulturore se kudo tjetër, prandaj Stambolli ka një trashëgimi shumë të begatshme kulturore.



Foto e disa nga shtat kodrat e qytetit të Stambollit

Pikat kryesore nga itinerari i vizitës në Stamboll

Muzeu Aja Sofja – Aja Sofja është ndërtuar në vitin 360 në kohën e Perandorisë Romake, të Perandorit Konstantini II si katedrale. Më vonë ajo është shkatërruar dhe rindërtuar tri herë deri në vitin 532 kur rindërtohet për herë të tretë me urdhër të Perandorit Bizantin, Justinjanit dhe merr pamjen që kryesisht e ka edhe sot. Që nga viti 360 e deri në vitin 1453 ajo ka shërbyer si katedrale Patriarkale Greke e Konstantinopojës, përveç në periudhën midis viteve 1204 dhe 1261 kur ka qenë e konvertuar në katedrale katolike nën Patriarkun Latin të Konstantinopojës, koha e Perandorisë Latine. Aja Sofja ka qenë selia e Patriarkut të Konstantinopojës dhe pika kryesore religjioze e Kishës Ortodokse Lindore për gati 1000 vjet. Në vitin 1453, në kohën e Perandorisë Otomane, me urdhër të Sulltan Mehmedit II ajo u shndërrua në xhami me ç’rast iu ndërtuan minaret dhe pjesë të tjera që i nevojiten një xhamie. Si xhami shërbeu deri në vitin 1931 kur u sekularizua dhe më pas në vitin 1935 shteti i sotëm turk e hap si muze që si i tillë shërben edhe sot. Kjo ndërtesë konsiderohet mishërim i arkitekturës bizantine dhe për të thuhet se “e ka ndërruar historinë e arkitekturës”. Ajo shquhet me kupolën e saj masive dhe me një koleksion të begatshëm të relikteve të shenjtë. Ka qenë katedralja më e madhe në botë për rreth 1000 vjet deri sa në vitin 1520 përfundon së ndërtuari Katedralja e Sevilës. Pasi që është shndërruar në xhami, ajo për rreth 500 vjet ka shërbyer si model për ndërtimin e xhamive të tjera të famshme si Xhamia e Sulltan Ahmedit, Xhamia Sylejmanie etj.

Foto Aja Sofia nga jashtë





Foto Aja Sofia nga brenda

Xhamia e Sulltan Ahmedit (Xhamia e Kaltër) – paraqet njërën nga xhamitë më madhështore që konsiderohet të jetë e fundit prej xhamive të mëdha e të famshme të periudhës klasike. Përveç që shërben si xhami, ajo sot është edhe njëri nga atraksionet turistik më të mëdhenj të Stambollit. Xhamia e Kaltër është ndërtuar nga viti 1609 deri në vitin 1616 në kohën e Perandorisë Otomane kur në fron ishte Sulltan Ahmedi I. Gjatë ndërtimit të saj, për arkitekturën e xhamisë arkitekti Mehmet Aga si model e ka marrë xhaminë Aja Sofja që është pranë saj, por edhe idenë e arkitektit më të famshëm të Perandorisë Otomane, arkitekt Sinanit dhe e ka sintetizuar në këtë kryevepër. Kombinimi i arkitekturës karakteristike për xhamitë e Perandorisë Otomane të shekujve XV dhe XVI dhe i asaj të kishave bizantine, në Xhaminë e Sulltan Ahmedit e ka arritur kulminacionin. Disa elemente bizantine që janë marrë nga Aja Sofja janë kombinuar me arkitekturën tradicionale islamike. Si shumë xhami tjera edhe kjo përmban varrin e themeluesit të saj, medresenë dhe bujtinën. Xhamia i ka 6 minare, kupolën kryesore dhe 8 kupola tjera pak më të vogla. Ngjitur me ndërtesën është oborri i madh, i mbyllur, tërësisht i rrethuar me pasazh i cili nga njëra anë ka murin e nga ana tjetër harqet e mbështetur në shtylla dhe është i mbuluar me kupola përgjatë tërë gjatësisë. Në mes të oborrit ndodhet një shatërvan i mbuluar me kupolë e cila është mbi 6 shtylla, ndërkaq në oborr hyhet përmes një porte monumentale. Në brendësi të xhamisë, për shkak të mureve të veshur me pllaka të kaltra, dominon ngjyra e kaltër dhe për këtë arsye xhamia njihet edhe me emrin Xhamia e Kaltër. Enterieri në nivelin e poshtëm të xhamisë dhe në galeri karakterizohet nga veshja me pllaka të qeramikës të punuara me dorë në mbi 50 disajne të ndryshme tulipani, lulesh, frutash dhe qiparisi. Nivelet e sipërm të enterierit dominohen nga ngjyra e kaltër. Aty janë më shumë se 200 dritare të shoqëruar me llambadarë. Elementi më i rëndësishëm brenda në xhami është mihrabi. Ai është i ndërtuar nga mermeri i gdhendur dhe i skulpturuar bukur. Në të djathtë të tij është minberi me një dekoracion shumë të pasur. Në këndin juglindor gjendet qoshku mbretëror përmes të cilit sigurohet qasja në lozhën mbretërore lartë në galerinë e xhamisë. Kjo lozhë mbështetet mbi 10 shtylla të mermerit dhe e ka mihrabin e vet të dekoruar me xhadë dhe cipë të pruar. Në mure janë disa pllaka të mëdha ku janë të gdhendur emra të kalifëve dhe vargje nga Kurani.



Foto e xhamisë nga jashtë


Muzeu Pallati Topkapi - Natyrisht që vizitat tona në Stamboll nuk kanë mundur ta anashkalojnë Pallatin Topkapi që tani është muze dhe njëri prej atraksioneve kryesore turistike të Stambollit. Ky është një ansambël i madh pallatesh që për afër 400 vjet (1465-1856) ka qenë rezidencë e sulltanëve të Perandorisë Otomane dhe oborr mbretëror. Ka qenë rezidencë perandorake dhe seli e qeverisë. Përveç si rezidencë mbretërore, pallati ka qenë edhe mjedis për raste të ndryshme shtetërore dhe mikpritje apo gostitje mbretërore. Topkapi ndodhet në “Zonën Historike të Stambollit” dhe më 1985 UNESCO e ka shpallur Vend të Trashëgimisë Botërore dhe sipas Kriterit IV e ka përshkruar si “shembulli më i mirë i ansambleve të pallateve të periudhës Otomane”. Ndërtimi i pallateve ka filluar në vitin 1459 me urdhër të Sulltan Mehmetit II pushtuesit të Konstantinopojës. Për ndërtim është zgjedhur lokacioni ku ka qenë akropolisi bizantin Byzantion. Fillimisht kur është ndërtuar, është quajtur Pallati i Ri (Yeni Sarayı) në mënyrë që të dallohet nga rezidenca e mëparshme. Emrin Topkapi e ka marrë në shekullin XIX sipas një porte (hyrje) me të njëjtin emër. Ansambli i pallateve është zgjeruar dhe ndryshuar me kalimin e viteve. Sulltanët që janë ndërruar gjatë viteve në kreun e perandorisë kanë shtuar dhe ndërruar diçka në Topkapi derisa kah fundi i shekullit XVI e ka arritur pamjen që e ka sot. Kah fundi i shekullit XVII, Pallati Topkapi gradualisht e humbë rëndësinë e tij kur Sulltanët preferonin të kalojnë më shumë kohë në pallatet e tyre të reja buzë Bosforit. Në vitin 1856 Sulltani Abdyl Mexhid vendosë që nga ai vit, pallat kryesor mbretëror të jetë pallati rishtazi i ndërtuar buzë Bosforit, Pallati Dollmabahçe. Disa funksione mbesin edhe më tutje në Topkapi. Pas rënies së Perandorisë Otomane më 1921, me një dekret qeveritar të shtetit të ri turk, më 1924 Pallati Topkapi transformohet në muze të epokës perandorake. Ky muze sot administrohet nga Ministria e Kulturës dhe Turizmit të Turqisë. Brenda ansambllit janë katër oborre kryesore, shumë ndërtesa më të vogla dhe haremi. Në Topkapi ka qindra dhoma, por publiku ka qasje vetëm në ato më të rëndësishmet. Shumë shembuj të mirë të arkitekturës otomane janë në Topkapi. Këtu është një koleksion i pasur i porcelanit, veshjeve, armëve, parzmorëve, miniaturave otomane, dorëshkrimeve dhe muraleve islamike si dhe një pjesë e thesarit dhe stolive të çmuara otomane. Në muze gjenden edhe relikte të shenjtë, shumë të rëndësishëm të botës muslimane duke përfshirë edhe pelerinën dhe shpatën e Profetit Muhamed.



Foto e hyrjes në muzeun Topkapi

Basilika Cistern (turqisht Yerebatan Sarnıcı) – Në mesin e shumë rezervuarëve nëntokësor të ujit që gjenden në Stamboll, Basilika Cistern është më i madhi dhe më i njohuri. Ndërtesa çfarë është sot u ndërtua në shekullin VI gjatë sundimit të Perandorit Bizantin Justiniani I. Emrin Basilika, ndërtesa e ka marrë nga sheshi publik i dikurshëm i Konstantinopojës, Stoa Basilica, nën të cilin është ndërtuar fillimisht. Para se të konvertohet në rezervuar të ujit, kjo ka qenë një bazilikë e madhe romake e ndërtuar midis shekujve III dhe IV gjatë Epokës së Hershme Romake. Basilika ka qenë një qendër tregtare, juridike dhe artistike. Perandori Justiniani I e ka rindërtuar dhe zmadhuar ndërtesën pas trazirave të mëdha të vitit 532 në Konstantinopojë të njohura me emrin Nika, të cilat e patën shkatërruar qytetin. Si rezervuar i ujit, ai e ka siguruar ujin për Pallatin e Madh të Konstantinopojës dhe ndërtesat në afërsi dhe më vonë ka vazhduar të sigurojë ujë edhe për Pallatin Topkapi gjatë periudhës Otomane e edhe në kohërat moderne. Ky rezervuar me përmasa të një katedraleje ndodhet nën tokë dhe ka një sipërfaqe prej rreth 9800 m² me kapacitet 80000 m³ ujë. Tavani mbështetet mbi 336 shtylla nga mermeri që janë 9 metra të larta dhe të renditura në 12 rreshta me nga 28 shtylla. Shumica e kapitelëve të shtyllave janë të stileve Jonik dhe të Korinthit me pak përjashtime kur kapitelët janë të stilit Dorik. Të gjitha ngarkesat, me anë të kupolave dhe harqeve të kulmit të ndërtesës bien mbi këto shtylla. 52 shkallë nga guri që janë në hyrje zbresin deri në brendi të ndërtesës. Muret e ndërtesës janë 4 metra të trashë, të ndërtuar nga tullat zjarrdruuese të lyera me llaç që nuk e lëshon ujin.

Foto e Bazilikës Cisternë



Kapali Çarshi - Çarshia e vjetër e Stambollit apo siç njihet me emrin Kapali Çarshi është pika tjetër interesante që ne e vizituam. Kapali Çarshi është njëri nga tregjet (pazaret) e mbuluar më të vjetër dhe më të mëdhenj në botë me 58 rrugë të mbuluara dhe 4000 dyqane që vizitohen nga 250.000 deri në 500.000 vizitorë në ditë. Ndërtimi ka filluar në vitin 1455 dhe pazari është hapur për blerësit në vitin 1461. Kapali Çarshi është i njohur për dyqanet e tij të argjendarisë, stolive të çmuara, artikujve të qeramikës, të erëzave dhe të tepihëve. Shumë stenda në pazar janë të grupuara sipas llojit të mallit me vende të veçanta për xhaketa të lëkurës, stoli të arit dhe të ngjashme. Pazari përmban edhe dy struktura me kube, të ndërtuara për deponim të mallit dhe për ruajtje të sigurt. E para prej tyre është ndërtuar midis viteve 1455 dhe 1461 me urdhër të Sulltan Mehmetit Pushtuesit. Kapali Çarshi është zgjeruar shumë në shekullin XVI në kohën e Sulltan Sylejmanit Të Madhërishmit, kurse në vitin 1894 është restauruar për shkak të dëmtimeve nga tërmeti. Në këtë pazar të mbyllur sot gjenden edhe dy xhami, dy hamame, katër fontana, restorante dhe kafene. Kompleksi përbëhet nga 12 ndërtesa kryesore dhe ka 22 dyer.



Foto të pazarit të vjetër

Pjesë të aktiviteteve gjatë qëndrimit në Stamboll dhe përjetim i veçantë për të gjithë pjesëmarrësit ka qenë shetitja me autobusin e dedikuar enkas për turistë dhe vizitor të Stambollit. Autobusët janë të tipit të hapur, që vizitorëve u mundësohet që në lëvizje të përjetojnë konfiguracionin shumë atraktiv, dhe pamjet mahnitëse të pikave më interesante të qytetit. Në mesin e këtyre pikave ishte: Dollmabashqë; Parku i monumenteve (maketa) karakteristike të trashëgimisë kulturore të Stambollit; Kalimi në pjesën aziatike të qytetit përmes Urës së mirënjohur të Bosforit; Objekti i vjetër i universitetit shtetëror; Lagje të pasura dhe të urbanizuara të qytetit etj.

Të shkosh në Stamboll, në njërën nga qendrat më të mëdha tregtare në botë, është e patejkalueshme vizita e qendrave shumë të mëdha tregtare që njëherit përfaqësojnë objektet e arkitekturës moderne me të gjitha elementet e saja karakteristike. Në kudër të vizitës u ndalëm në tri qendra që në bazë të preferencave ishin edhe ndër më të njohurat në Stamboll (Qendra Istinye; Olivium dhe Istambull Forum). Përpos mundësive dhe shërbimeve të ndryshme që të ofrojnë, të mahnitshme ishin zgjidhjet arkitektonike dhe konstruksioni i përdorur që e bëjnë Stambollin të veqohet edhe në këtë drejtim.



Foto nga brenda e qendrave të vizituara



Një përjetim i veçantë ishte vizita që i kemi bërë lagjes Taksim, njëres nga rrugët më të njohura dhe më të shtrenjta në qytetin e Stambollit. U impresionuam shumë me arkitekturën e rrugës, me raportin e ndërtimeve të vjetra dhe ndërtimeve të reja. Pamja dhe gërshetimi me mjeshtri i tyre tregon për një traditë të gjatë dhe të qëndrueshme të ndërtimit. Pamjen e bënin edhe më madhështore dekorimet dhe dritat e shumta që paralajmëronin festat e fund-vitit.

Foto nga rruga Taksim



Në fund

Përshtypja e përgjithshme ishte se vizita u tregua shumë e rëndësishme dhe përpos motit që nuk ishte në anën tonë, të gjitha pikat e parapara u realizuan me shumë sukses. Ajo që mund të nxirret si përfundim është se, trashëgimia kulturore për një vend ka rëndësi shumë të madhe dhe paraqet një burim të pashtershëm për gjenerimin e mjeteve financiare. Në bazë të informative të nxjerra nga statistikat e shumta dhe nga ajo që shihej në çdo vend që vizituam – konstatojmë se turizmi është njëra nga degët më të fuqishme ekonomike të qytetit të Stambollit. Dhe ajo që është më e rëndësishme, trendi i zhvillimit të kësaj dege është në rritje të vazhdueshme falë përkujdesjes ndaj trashëgimisë në të gjitha format e saja, dhe politikave të drejta të niveleve të ndryshme të vendimmarrjes. Një qasje e tillë vërehet dhe respektohet me fanatizëm nga të gjithë për faktin se, përfitimet janë shumë të mëdha - nga të cilat proporcionalisht po të gjithë përfitojnë.

Në emër të grupit,

Arbni, Luani dhe Festa

Instituti për Planifikim Hapësinor
AMMK/MMPH